


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Korrik 2017

Tiranë, më 08 Gusht 2017: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Korrik 2017, arriti 102,3 kundrejt muajit Dhjetor 2015.

Në Korrik 2017 ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit është 2,0 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 1,9 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të Indeksit të Çmimeve të Konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Korrik është ndikuar kryesisht nga grupi “ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,71 pikë përqindje. Çmimet e grupit “qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” kanë kontribuar me +0,22 pikë përqindje. Çmimet e grupit “mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,17 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “pije alkoolike dhe duhan” dhe “shërbimi arsimor” kanë kontribuar me +0,03 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “transport” dhe “komunikimi” kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje secili. Çmimet e grupeve “veshje dhe këpucë” dhe “mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje” kanë kontribuar me -0,07 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “argëtim e kulturë” kanë kontribuar me -0,03 pikë përqindje.

Për publikim 08/08/2017

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Korrik 2016, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “ushqime dhe pije joalkoolike” me 4,7 %, pasuar nga grupet “mallra dhe shërbime të ndryshme” me 3,4 %, “qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1,1 %, “pije alkoolike dhe duhan” dhe “shërbimi arsimor” me nga 0,7 % secili, “komunikimi” me 0,6 %, “transporti” me 0,4 %, etj. Brenda grupit të ushqimeve, çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” u rriten me 13,7 %, pasuar nga nëngrupet “fruta” me 11,2 %, “peshk” me 4,3 %, “qumësht, djath e vezë” me 4,1%, “sheqer, reçelna e ëmbëlsira” me 3,1 %, etj. Nga ana tjetër çmimet e nëngrupit “vajra dhe yndyrna” u ulën me 3,0 %. Ulja më e madhe vjetore e çmimeve vërehet në grupin “veshje dhe këpucë” me 1,7 %, pasuar nga grupet “argëtim dhe kulturë” dhe “mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje” me nga 0,1 % secili.

Ndryshimi mujor i indeksit është - 0,1 %. Krahasuar me Qershor 2017, ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupet “argëtim dhe kulturë” me 0,9 %, pasuar nga grupet “mallra dhe shërbime të tjera” me 0,4 %, “ushqime dhe pije joalkoolike” me 0,3 %, “pije alkoolike dhe duhan” me 0,1 %. Rritje mujore e çmimeve vërehet në grupet “veshje dhe këpucë” me 0,6 % dhe “transporti” me 0,4 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	07-16	08-16	09-16	10-16	11-16	12-16	01-17	02-17	03-17	04-17	05-17	06-17	07-17
	Gjithsej	100,0	100,2	101,1	101,5	101,2	101,3	102,2	103,7	104,3	104,7	104,0	102,8	102,4	102,3
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	40,0	100,4	102,8	103,1	102,4	101,9	104,6	108,5	110,1	110,6	109,1	106,2	105,5	105,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,4	101,0	100,9	100,9	101,1	100,9	101,3	101,4	101,4	101,7	101,9	101,7	101,7	101,6
3	Veshje dhe këpucë	4,0	98,1	98,1	99,9	100,3	100,6	100,9	99,9	97,6	97,7	96,0	96,4	95,8	96,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,7	100,3	100,2	100,4	100,5	101,5	100,9	101,1	101,3	101,8	101,5	101,4	101,4	101,4
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,5	100,5	100,5	100,2	99,6	100,2	100,2	100,3	100,1	99,9	99,9	99,9	99,8	99,4
6	Shëndeti	3,0	100,1	100,0	100,1	100,0	100,2	100,2	100,3	100,3	100,2	100,1	100,2	100,1	100,1
7	Transporti	6,2	99,4	99,8	99,5	99,6	99,5	99,2	99,4	98,9	99,9	100,4	99,7	99,3	99,7
8	Komunikimi	2,5	99,9	99,9	100,5	100,5	100,7	100,6	100,2	100,2	100,2	100,5	100,5	100,5	100,5
9	Argëtim dhe kulturë	2,6	101,7	101,4	101,7	101,2	100,9	102,3	103,3	103,0	103,3	104,7	102,2	101,5	100,6
10	Shërbimi arsimor	2,5	100,0	100,0	99,9	100,4	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7
11	Hotele, kafene dhe restorante	2,9	100,1	100,1	100,1	100,1	100,0	100,1	100,1	100,2	100,2	100,2	100,2	100,1	100,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,7	100,0	100,4	103,3	103,1	103,1	103,3	103,2	103,2	103,5	103,3	103,3	103,4	103,4

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	07-16/07-15	08-16/08-15	09-16/09-15	10-16/10-15	11-16/11-15	12-16/12-15	01-17/01-16	02-17/02-16	03-17/03-16	04-17/04-16	05-17/05-16	06-17/06-16	07-17/07-16
	Gjithsej	1,9	2,0	1,8	1,5	1,9	2,2	2,8	2,2	2,1	1,9	2,0	2,2	2,0
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	4,3	4,7	3,7	3,1	3,2	4,6	5,8	3,9	3,3	3,0	3,8	5,1	4,7
2	Pije alkoolike dhe duhan	1,7	1,4	1,4	1,6	1,5	1,3	0,9	0,6	0,5	1,0	0,8	0,8	0,7
3	Veshje dhe këpucë	-1,3	-0,4	1,4	1,0	0,8	0,9	0,6	-0,4	-0,7	-2,3	-2,1	-2,5	-1,7
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,0	0,0	0,1	0,5	1,5	0,9	0,4	0,6	1,1	0,9	0,9	0,9	1,1
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	1,0	0,8	0,8	0,3	0,7	0,2	-0,1	-0,2	-0,1	-0,3	-0,4	-0,5	-1,1
6	Shëndeti	0,1	-0,1	-0,2	-0,5	0,2	0,2	0,2	0,2	0,1	-0,1	0,2	-0,1	0,0
7	Transporti	-3,3	-2,2	-1,7	-1,5	-0,5	-0,8	2,8	3,2	3,8	4,3	2,6	0,7	0,4
8	Komunikimi	-1,2	-0,1	0,5	0,5	0,7	0,6	0,2	0,2	-0,1	0,6	0,6	0,5	0,6
9	Argëtim dhe kulturë	2,8	2,4	1,7	1,0	0,8	2,3	3,1	2,8	3,2	4,5	2,0	0,6	-1,1
10	Shërbimi arsimor	4,8	4,4	3,8	0,4	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7
11	Hotele, kafene dhe restorante	1,0	0,8	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,2	0,2	0,1	0,1	0,0	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,1	0,7	2,6	3,0	2,7	3,3	3,2	3,0	3,4	3,1	3,0	3,2	3,4

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	07-16	08-16	09-16	10-16	11-16	12-16	01-17	02-17	03-17	04-17	05-17	06-17	07-17
	Gjithsej	0,1	0,9	0,3	-0,2	0,1	0,9	1,5	0,5	0,4	-0,6	-1,2	-0,3	-0,1
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	0,1	2,3	0,3	-0,7	-0,5	2,7	3,7	1,5	0,5	-1,4	-2,7	-0,7	-0,3
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,0	-0,1	0,0	0,2	-0,3	0,4	0,1	0,0	0,3	0,2	-0,2	0,1	-0,1
3	Veshje dhe këpucë	-0,3	0,0	1,8	0,4	0,3	0,3	-1,0	-2,3	0,1	-1,7	0,3	-0,5	0,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	-0,1	0,0	0,2	0,1	1,0	-0,6	0,2	0,2	0,5	-0,3	-0,1	0,0	0,0
5	Mobililje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,2	0,0	-0,2	-0,6	0,6	0,0	0,1	-0,1	-0,2	0,0	0,0	-0,1	-0,4
6	Shëndeti	0,0	-0,2	0,1	-0,2	0,3	-0,1	0,1	0,0	0,0	-0,1	0,1	-0,1	0,0
7	Transporti	0,8	0,4	-0,3	0,1	-0,1	-0,3	0,2	-0,5	1,0	0,5	-0,7	-0,4	0,4
8	Komunikimi	-0,1	0,0	0,6	0,0	0,2	0,0	-0,4	0,0	0,0	0,3	0,0	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	0,8	-0,3	0,3	-0,5	-0,3	1,4	0,9	-0,3	0,4	1,3	-2,4	-0,7	-0,9
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	-0,1	0,5	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,1	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	-0,1	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,2	0,3	2,9	-0,1	-0,1	0,2	0,0	-0,1	0,3	-0,2	0,0	0,1	0,0

Shpjegime Metodologjike

- Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjise ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2015.
- Lista e mallrave dhe shërbimeve është përditësuar, në 332 mallra dhe shërbime nga 333 që ishte në vitin e kaluar.
- Lista e njësive tregtare ku mblidhen çmimet është përditësuar.

- Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve. IÇK në vitin **t** llogaritet me strukturën e shpenzimeve të vitit **(t-1)**

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.